



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 4619/prot.
11

Tiranë, më 8 . 8 .2025

UDHËZIM

Nr. 4619, datë 8 . 8 .2025

PËR

**ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 292, DATË 28.05.2025, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË MËNYRËS DHE TË
RREGULLAVE PËR RIKTHIMIN E USHTARAKËVE NË REZERVË NË SHËRBIMIN
AKTIV TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 13, pika 2, germa "f", të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 31, të ligjit nr. 59/2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 292 datë, 28.05.2025, "Për përcaktimin e procedurave, të mënyrës dhe rregullave për rikthimin e ushtarakëve në rezervë në shërbimin aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura,

U D H Ë Z O J:

KREU I

TË PËRGJITHSHME

1. Objekti.

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rolit dhe përgjegjësi të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura për zbatimin e procedurave të rikthimit të ushtarakut në rezervë në shërbimin aktiv, mënyra dhe procedura e aplikimit, komisionet e vlerësimit të kandidatëve, përgjegjësitë dhe procedurat e punës së tyre, si dhe rritullimi dhe emërimi në detyrë në shërbim aktiv.

2. Qëllimi.

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave, procedurave dhe afateve të nevojshme për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 292, datë, 28.05.2025,

“Për përcaktimin e procedurave, të mënyrës dhe rregullave për rikthimin e ushtarakëve në rezervë në shërbimin aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, duke garantuar respektimin e parimeve të barazisë, meritokracisë, mos diskriminim për shkak të racës, etnisë, ngjyrës, gjinisë, përkatësisë fetare, vendbanimit.

3. Fusha e zbatimit.

Ky udhëzim zbatohet në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura, të cilat për nevoja të ruajtjes së operacionalitetit, kërkojnë plotësimin me personel të kualifikuar nga ushtarakët në rezervë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU II

STRUKTURAT DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE

4. Strukturat përgjegjëse për rikthimin e ushtarakëve në rezervë në shërbimin aktiv të Forcave të Armatosura janë:

- a) Komandat e Forcave dhe strukturave Mbështetëse, si dhe institucionet dhe repartet në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA.
- b) Drejtoria e Personelit në SHP (J-1).
- c) Drejtoria përgjegjëse për Burimet Njerëzore, në Ministrinë e Mbrojtjes.
- d) Qendra e Personel Rekrutimit (QPR).
- e) Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes (QKMBM).
- f) Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM).
- g) Policia Ushtarake (PU).
- h) Njësia Mjekësore Ushtarake (NJMU).

5. Komandat e Forcave dhe strukturave Mbështetëse, si dhe institucionet dhe repartet në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA, përgjigjen për:

- a) Përcaktimin e nevojave.
- b) Kategorizimin e personelit të ndarë:
 - i. për oficer, nënoficer, ushtar/detar aktiv.
 - ii. specialiteteve ushtarake.
 - iii. reparteve që kanë nevojë për plotësim me personel.
- c) Hartimin e planit për plotësim me personel të strukturave të tyre, në rastet e mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm.
- d) Dërgimin e nevojave dhe planit për plotësim me personel për miratim tek Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

6. Drejtoria e Personelit në Shtabin Përgjithshëm të FA (J-1) përgjigjet për:

- a) Hartimin e kërkesave dhe nevojave për rikthimin në shërbimin aktiv sipas kategorisë së personelit të ndarë; oficer, nënoficer, ushtar/detar aktiv me specialitete ushtarake dhe repartet që kanë nevojë për plotësim me personel, mbështetur në propozimin e strukturave ushtarake.

- b) Dërgimin për miratim tek Ministri i Mbrojtjes i nevojave për rikthimin në shërbimin aktiv sipas kategorisë së personelit të ndarë; oficer, nënoficer, ushtar/detar aktiv me specialitete ushtarake dhe reparte.
- c) Përgatitjen e praktikave shkresore për anëtarët e komisionit të vlerësimit për rikthimin e ushtarakëve në rezervë në shërbim aktiv të kandidatëve për oficer dhe dërgimin për miratim tek Ministri i Mbrojtjes.
- d) Përgatitjen e praktikave shkresore për anëtarët e komisionit të vlerësimit për rikthimin e ushtarakëve në rezervë në shërbim aktiv të kandidatëve për nënoficer, ushtar/detar aktiv, si dhe urdhrin përkatës të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
- e) Përgatitjen e praktikave shkresore për anëtarët e komisionit të shqyrtimit të ankimit për rikthimin e ushtarakëve në rezervë në shërbim aktiv, të kandidatëve për oficer dhe dërgimin për miratim tek Ministri i Mbrojtjes.
- f) Përgatitjen e praktikave shkresore për anëtarët e komisionit të shqyrtimit të ankimit për rikthimin e ushtarakëve në rezervë në shërbim aktiv, të kandidatëve për nënoficer, ushtar/detar aktiv, si dhe urdhrin përkatës të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
- g) Përgatitjen e praktikës për miratimin e listës së kandidatëve fitues për oficer dhe dërgimin për miratim tek Ministri i Mbrojtjes.
- h) Përgatitjen e praktikës për miratimin e listës së kandidatëve fitues për nënoficer, ushtar/detar aktiv, si dhe dërgimin për miratim Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
- i) Mbështetur në propozimet e strukturave të Forcave të Armatosura, harton planin për plotësim me personel të strukturave, sipas kategorisë së personelit oficer, nënoficer, ushtar/detar aktiv në rastet e mobilizimit të përgjithshëm, ose të pjesshëm dhe e dërgon për miratim tek Ministri i Mbrojtjes.
- j) Pas miratimit të listës fitues të kandidatëve nënoficer dhe ushtar/detar aktiv, përgatit praktikat për rritullim dhe emërim në detyrë.

7. Drejtoria përgjegjëse për Burimet Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, përgjigjet për:

- a) Përgatitjen e praktikave shkresore për ngritjen e komisionit të vlerësimit për rikthimin e ushtarakëve në rezervë në shërbim aktiv të kandidatëve për oficer sipas propozimit të SHPPFA.
- b) Përgatitjen e praktikave shkresore për ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankimit për kandidatët për oficerë me propozim të SHSHPPFA me përbërje; 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në MM, 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria e Personelit në SHPPFA dhe anëtarët e tjerë caktohen përfaqësues nga QPR.
- c) Përgatitjen e praktikës shkresore për Ministrinë e Mbrojtjes të nevojave për rikthim në shërbim aktiv sipas kategorisë së personelit të ndarë për oficer, nënoficer, ushtar/detar aktiv me specialitete dhe komanda/reparte.
- d) Pas miratimit të nevojave, në bashkëpunim QPR/QKMBM kryen publikimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, i të dhënave të nevojshme për

specialitetet e kërkuara, afatet e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për rikthimin e ushtarakëve në rezervë në shërbim aktiv.

- e) Pas miratimit të listës fitues të kandidatëve oficer, sipas propozimeve të SHPFA, përgatit praktikat për rritullim dhe emërim në detyrë.
- f) Përgatitjen e praktikës për miratim nga Ministri i Mbrojtjes të planit për plotësim me personel të strukturave, sipas kategorisë personelit oficer, nënoficer, ushtar/detar aktiv në rastet e mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm, sipas propozimit të SHPFA.
- g) Pas miratimit, ndjek procedurën e njoftimit në median kombëtare për rastet e mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm, si dhe në bashkëpunim me QKMBM kryen publikimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Qendra e Personel-Rekrutimit përgjigjet për:

- a) Dërgimin e njoftimit për publikimin në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes të procedurës, kriterëve, dokumentacionit dhe afatit të dorëzimit tyre për rikthim në shërbim aktiv në Forcat e Armatosura, në bashkëpunimin me QKMBM.
- b) Administrimin e dokumenteve të kandidatëve për rikthim në shërbim aktiv sipas kërkesave të përcaktuara.
- c) Kryerjen e verifikimit të dosjes të aplikimit të kandidatëve për rikthim në shërbim aktiv, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit. Në rast konstatimi se dokumentacioni nuk është i plotë, kandidati njoftohet nëpërmjet portalit “e-Albania”, ose zyrtarisht dhe forma të tjera komunikimi, për plotësimin e dokumentacionit brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit.
- d) Në përfundim të afatit të njoftimit, i përcjell komisionit të vlerësimit listën së bashku me dokumentacionin e aplikimit.
- e) Sigurimin e dokumentacionit të përcaktuar në shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 6, të VKM nr.292, datë 28.05.2025, me autorizim të kandidatit.
- f) Dërgimin e listës së kandidatëve për rikthim në Forcat e Armatosura për verifikimin e kushtit të sigurisë në AISM dhe PU.
- g) Dërgimin e listës së kandidatëve për rikthim në Forcat e Armatosura për kontroll mjekësor në NJMU.
- h) Mbështet komisionet e vlerësimit për rikthim në shërbim aktiv dhe të ankimimit me materialet e nevojshme që administron QPR për kryerjen e punës.
- i) Administron dokumentacionin e komisioneve të vlerësimit dhe të ankimimit për rikthim në shërbim aktiv.
- j) Njofton kandidatët, nëpërmjet portalit “e-Albania”, vendimin e komisionit të vlerësimit me vulë elektronike/nënshkrim elektronik, së bashku me arsyetimin përkatës.
- k) Administron ankimimet e kandidatëve të skualifikuar për rikthim në shërbim aktiv.
- l) Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të paraqitjes së ankimit, i njofton kandidatin vendimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit me vulë elektronike/nënshkrim elektronik, nëpërmjet portalit “e-Albania”.

- m) Në përfundim të procedurës së vlerësimit dhe ankimit, Qendra e Personel Rekrutimit dërgon listat e kandidatëve fitues në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
- n) Në rastet e mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm, shpalljes në median kombëtare dhe publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, njofton me shkrim dhe përmes postës elektronike ushtarakun në rezervë për rikthim në shërbimin aktiv, duke adresuar zyrën ku duhet të paraqitet, për të vijuar me procedurën e emërimit.
- o) Të njoftojë strukturat e sigurimeve shoqërore për fillimin e marrëdhënieve financiare si ushtarak i rikthyer në shërbimin aktiv, si dhe ndërpresë marrëdhëniet financiare në rastet e trajtimit me pagesë kalimtare të ushtarakëve të rikthyer.
- p) Të menaxhojë sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe pasurimin e dosjeve personale të ushtarakëve të rikthyer në shërbim aktiv duke përditësuar me urdhrat e autoriteteve për rritullim, gradim, emërim, etj, për ushtarakët e rikthyer në shërbim aktiv.

9. Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, përgjigjet për:

- a) Publikimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, të të dhënave të nevojshme për specialitetet e kërkuara, afatet e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për rikthimin e ushtarakëve në rezervë në shërbim aktiv.

10. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Policia Ushtarake (PU), përgjigjet për:

- a) Kontrollin e plotësimit të kushtit të sigurisë të kandidatëve të ushtarakëve në rezervë sipas listës së dërguar nga QPR për t'u rikthyer në shërbimin aktiv. Lista e verifikimit të kushtit të sigurisë të kandidatëve për rikthim në shërbimin aktiv nga AISM dhe PU, të dërgohen në QPR, me shënimin: "plotëson kushtin e sigurisë" ose "nuk e plotëson kushtin e sigurisë".

11. Njësia Mjekësore Ushtarake përgjigjet për;

- a) Vlerësimin e gjendjes fiziko - shëndetësore të përgjithshme të kandidatëve për rikthim në FA, sipas listës së dërguar nga Komandanti i Qendrës së Personel Rekrutimit.
- b) Në përfundim të vlerësimit, komisioni mjekësor i NJMU-së, vendos nëse kandidati është i aftë për rikthim në Forcat e Armatosura ose jo.
- c) Brenda dy ditëve nga përfundimi i vlerësimit të gjendjes fiziko - shëndetësore të përgjithshme, NJMU i dërgon me shkrim QPR vendimin e komisionit mjekësor për çdo kandidat.

KREU II

KRITERET, PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR RIKTHIMIN E USHTARAKËVE NË REZERVË NË SHËRBIM AKTIV NË FA

12. Kriteret e përgjithshme për rikthim në shërbim aktiv.

Për rikthimin në shërbim aktiv, kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar.
- b) të ketë qenë ushtarak aktiv të Forcave të Armatosura si oficer, nënoficer ose ushtar/detar aktiv.
- c) të mos jetë dënuar.
- d) të mos jetë në ndjekje penale dhe në proces gjyqimor.
- e) të mos jetë larguar nga administrata publike për shkelje disiplinore (në rastet e punësimit).
- f) të jetë i aftë nga ana shëndetësore.
- g) të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse të sigurisë.
- h) të kenë moshë të tillë që mundëson lidhjen e të paktën një kontrate shërbimi ushtarak me afat 3 vjeçar.

13. Procedurat e aplikimit për rikthim në shërbim aktiv.

- a) Kandidati/aplikanti (ushtaraku në rezervë) për rikthimin në shërbim aktiv në FA si oficer, nënoficer dhe ushtar/detar aktiv, aplikon nëpërmjet platformës “e-Albania”, dhe/ose në *hard-copy* pranë seksioneve të rekrutimit në qarqe dhe në Qendrën e Personel Rekrutimit duke plotësuar formularin e aplikimit për rikthimin e ushtarakëve në rezervë në shërbim aktiv dhe dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të shpallura, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Mbrojtjes.
- b) Kandidati/aplikanti (ushtaraku në rezervë) për rikthim në Forcat e Armatosura, duhet të paraqesë nëpërmjet platformës “e-Albania”, sistemit AMS dhe/ose në *hard-copy* në Qendrën e Personel Rekrutimit dokumentacionin shoqërues të saj, origjinal apo të njëzuar me të, si më poshtë:
 - i. Formulari i vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr.138/2015.
 - ii. Jetëshkrimi.
 - iii. Vërtetimi i gjendjes gjyqësore.
 - iv. Vërtetimi nga prokuroria që kandidati nuk është në procedim penal.
 - v. Vërtetimi nga gjykata e rrethit gjyqësor që kandidati nuk është në proces gjyqësor penal.
 - vi. Vërtetimi që kandidati të mos jetë larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike.
 - vii. Vërtetimi mjekësor (dokumenti i aftësisë për punë i qendrës shëndetësore të lëshuar nga mjeku i familjes).
 - viii. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me listën e notave, për kohën që ka qenë jashtë Forcave të Armatosura, nëse ka.
 - ix. Fotokopje e noterizuar e kualifikimeve të nevojshme për specialitetin që kërkohet rikthimi në shërbimin aktiv, nëse ka.

- c) Qendra e Personel-Rekrutimit kryen verifikimin e dosjes të aplikimit brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit. Në rast se konstatohet se dokumentacioni nuk është i plotë, kandidati njoftohet nëpërmjet platformës “e-Albania”, dhe/ose dërgohet nëpërmjet shërbimit postar në adresën e deklaruar për plotësimin e dokumentacionit brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit. Në përfundim të afatit të njoftimit, Qendra e Personel Rekrutimit pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura i përcjell listën së bashku me dokumentacionin e aplikimit.
- d) Deri në momentin e krijimit të infrastrukturës së nevojshme teknike për ngritjen e sistemit për kryerjen e procesit të aplikimit dhe ankimit nëpërmjet platformës “e-Albania”, dokumentacioni do të paraqitet në *hard-copy* pranë Qendrës së Personel Rekrutimit.
- e) Qendra e Personel Rekrutimit siguron me autorizim të kandidatit dhe/ose marrjes së aksesit në platformën “e-Albania”, nëpërmjet ndërveprimit institucional dokumentacionin e përcaktuar në shkronjat “c”, “d”, “e” dhe “f”, të pikës 12, të këtij udhëzimi.
- f) Në rastet kur për arsye teknike nuk mund të shkarkohet nga QPR nëpërmjet portalit e-Albania, kandidati të sigurojnë vetë dokumentacionin e kërkuar nga institucionet përkatëse.

KREU III

KOMISIONET, PËRGJEGJËSITË DHE PROCEDURAT E PUNËS SË VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

14. Komisionet e vlerësimit dhe shqyrtimit ankimit për rikthimin në shërbim aktiv në FA.

Llojet e komisioneve, objekt i këtij udhëzimi për rikthimin në shërbim aktiv në FA si oficer, nënoficer dhe ushtar/detar aktiv, janë;

- a) Komisioni i vlerësimit për kandidatët oficerë përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
- b) Komisioni i vlerësimit për kandidatët nënoficerë dhe ushtarë/detarë përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
- c) Komisioni i shqyrtimit të ankimit për kandidatët oficerë i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.
- d) Komisioni i shqyrtimit të ankimit për kandidatët nënoficerë dhe ushtarë/detarë përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
- e) Në ndihmë të komisioneve të vlerësimit dhe komisioneve të shqyrtimit të ankimit, caktohet një sekretar i cili duhet të jetë nga Qendra e Personel Rekrutimit.

- f) Komisionet funksionojnë pranë Qendrës Personel Rekrutimit brenda kohës përcaktuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Mbrojtjes/Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
- g) Komisioni i vlerësimit kryen procedurën e vlerësimit të kandidatëve brenda 10 (dhjetë) ditëve.
- h) Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit, komisioni i vlerësimit i përcjell Qendrës së Personel Rekrutimit vendimmarrjen, së bashku me arsyetimin përkatës për secilin kandidat.

15. Detyrat e komisionit të vlerësimit.

- a) Vlerëson të gjithë kandidatët që aplikojnë për rikthim në shërbim aktiv në FA dhe kanë paraqitur dokumentet e kërkuara sipas këtij udhëzimi.
- b) Shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin sipas kategorisë së personelit dhe harton listën e vlerësimit të kandidatëve fitues sipas kriterëve të përcaktuar.
- c) Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit, i përcjell Qendrës së Personel Rekrutimit vendimmarrjen së bashku me arsyetimin përkatës për secilin kandidat.

16. Procedurat e përzgjedhjes.

- a) Komisioni i vlerësimit kryen procedurën e përzgjedhjes ku përfshihen dhe vlerësohen:
 - i. Përzgjedhja paraprake (verifikimi i dokumentacionit paraqitur).
 - ii. Vlerësimi i dokumenteve dhe vlerësimi i intervistës së strukturuar me gojë (verifikimi i intervistës të bëhet vetëm për kategorinë oficer).
- b) Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve për kategorinë oficer është 100 (njëqind) pikë, të cilat ndahen:
 - i. 60 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve.
 - ii. 40 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.
- iii. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve për nënoficer dhe ushtar/detar aktiv është 100 (njëqind) pikë, vetëm me dokumentacion.
- c) Vlerësimi i dokumentëve të kandidatëve përfshin:
 - i. vlerësimin e jetëshkrimit (CV).
 - ii. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike.
 - iii. vlerësimin e trajnimeve.
 - iv. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës në rastet e pozicioneve drejtuese, eksperiencës dhe aftësive drejtuese.
- d) Pikët totale të vlerësimit të dokumentëve për oficer ndahen, si më poshtë:
 - i. jetëshkrimi, 10 pikë.
 - ii. arsimimi/kualifikimi, deri 15 pikë.
 - iii. trajnimi, deri 10 pikë.

- iv. eksperiencia/përvoja në punë, deri 25 pikë.
- e) Pikët totale të vlerësimit të dokumentëve për nënoficer dhe ushtar/detar aktiv ndahen, si më poshtë:
 - i. jetëshkrimi, 20 pikë.
 - ii. arsimimi/kualifikimi, deri 30 pikë.
 - iii. trajnimi, deri 25 pikë.
 - iv. eksperiencia/përvoja në punë, deri 25 pikë.
- f) Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve për oficer përdoret formulari nr.1, për çdo anëtar dhe formulari nr.1/2, për komisionin, ndërsa për nënoficer dhe ushtar/detar aktiv përdoret formulari nr.1/1, për çdo anëtar dhe formulari nr.1/3, për komisionin, bashkëlidhur këtij dokumenti.
- g) Vlerësimi i intervistës/afësive profesionale;
 - i. Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët oficerë që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e do kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilin profesional të kandidatit, me pozicionin që do të mbulojë.
 - ii. Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilin profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.
 - iii. Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Sasia dhe lloji i pyetjeve përcaktohen nga komisioni. Në total intervista ka 40 pikë. Për vlerësimin e kandidatëve gjatë intervistës përdoret formulari nr.2 për çdo anëtar komisioni si dhe formulari nr.2/1 për komisionin, bashkëlidhur këtij dokumenti.
 - iv. Secili anëtar i komisionit e bën vlerësimin për secilin kandidat në mënyrë të pavarur, sipas formularit përkatës.
 - v. Pas vlerësimit të pavarur, për secilin kandidat, anëtarët e komisionit mund të diskutojnë rreth performancës së kandidatëve gjatë intervistës.
 - vi. Pas diskutimit, secili anëtar i komisionit i rishikon (nëse është e nevojshme) dhe i plotëson formularët për secilin kandidat dhe i nënshkruan.
 - vii. Pas vlerësimit të pavarur të anëtarëve të komisionit, plotësohet formulari i përbashkët për vlerësimin e intervistës. Formulari nënshkruhet nga 3 (tre) anëtarët e komisionit.
 - viii. Në mbyllje të procesit të vlerësimit, kandidatët listohen sipas meritës, duke përfshirë pikët e vlerësimit të dokumenteve dhe pikët e vlerësimit të intervistës.
 - ix. Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit, komisioni i vlerësimit i përcjell Qendrës së Personel Rekrutimit vendimarrjen, së bashku me arsyetimin përkatës për secilin kandidat.
 - x. Kundër vendimit të komisionit të vlerësimit, ushtrohet ankim sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative, nëpërmjet platformës “e-Albania”.

17. Detyrat e komisionit të shqyrtimit ankimit;

- a) Të shqyrtojë të gjitha ankesat e paraqitura nga kandidatët pranë QPR, brenda afatit të ankimit.
- b) Të vlerësojë nëse ankesat e paraqitura, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 59/2014, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.292, datë 28.05. 2025.
- c) Në përfundim të procedurës së ankimit, harton listën përfundimtare dhe e dërgon pranë Qendrës së Personel Rekrutimit.

18. Përgjegjësitë e sekretarit të komisioneve.

a) Përgjegjësitë e sekretarit të komisionit të vlerësimit:

- i. Siguron dokumentacionin nga QPR.
- ii. Lajmëron e anëtarët e komisionit për vendin, kohën dhe qëllimin e mbledhjes.
- iii. Mban procesverbalin e mbledhjes së komisionit.
- iv. Bën shpalljen e listave dhe merr masa për lajmërimin e personelit oficer për intervistë.
- v. Dërgon në QPR relacionin përfundimtar dhe listat e kandidatëve të vlerësuar.
- vi. Evidenton në relacionin përfundimtar problematikat e dala gjatë procesit të detajuar rasta pas rasti me emra.

b) Përgjegjësitë e sekretarit të komisionit të shqyrtimit të ankimit:

- i. Siguron dokumentacionin nga QPR.
- ii. Lajmëron e anëtarët e komisionit për vendin, kohën dhe qëllimin e mbledhjes.
- iii. Mban procesverbalin e mbledhjes së komisionit.
- iv. Bën shpalljen e listave dhe merr masa për lajmërimin e personelit oficer për intervistë.
- v. Dërgon në QPR relacionin përfundimtar dhe listat e kandidatëve të vlerësuar.
- vi. Evidenton në relacionin përfundimtar problematikat e dala gjatë procesit të detajuar rasta pas rasti me emra.

19. Procedurat e punës për komisionin e shqyrtimit të ankimit të kandidatëve për rikthimin në shërbim aktiv.

- a) Kandidatët kanë të drejtë që, brenda 5 ditëve nga shpallja e rezultateve, të ankohen me shkrim në Qendrën e Personel Rekrutimit në lidhje me vlerësimin.
- b) Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, i ngritur pranë Qendrës së Personel Rekrutimit, shqyrton ankesat brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit të ankimit dhe i kthen përgjigje me shkrim të interesuarave, brenda 24 orëve nga përfundimi i shqyrtimit të ankesave.

20. Procedurat e rritullimit, gradimit dhe emërimit të kandidatit që rikthehet në FA;

- a) Në bazë të kompetencave të përcaktuar në ligjin 59/2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura", i ndryshuar, sipas kategorisë personelit.

- b) Rititullimi, gradimi dhe emërimi në detyrë bëhet sipas kompetencave ligjore me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, sipas listës së kandidatëve fitues të përzgjedhur për rikthim në FA nga komisioni përkatës në QPR, si dhe për emërim në detyrë, bazuar në propozimin e komandantit të Forcës/Komandës Mbështetëse/AFA, komandantit/drejtuesit të strukturës autonome.
- c) Një kopje e urdhrave të rititullimit, gradimit dhe emërimit në detyrë dërgohet në çdo strukturë ushtarake përkatëse të emëruar si dhe në QPR, për t'u administruar në dosjen personale të ushtarakut.

21. Të drejtat dhe detyrimet e ushtarakëve në rikthim;

- a) Ushtarakët në rikthim përfitojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që gëzon ushtaraku aktiv, me përjashtim të arsimimit institucional dhe përparimin në gradë.
- b) Ushtarakut të rikthyer në shërbimin aktiv, i ndërpriten përfitimet e tjera që rrjedhin nga ligji nr.10142, datë 15.05.2009, i ndryshuar, që nga momenti i fillimit të marrëdhënieve financiare si ushtarak aktiv.
- c) Vjetërsia e shërbimit si ushtarak aktiv pas rititullimit (rikthimit në shërbimin aktiv), për efekt të pagës, përfitimit të pensionit të parakohshëm dhe pensionit të pleqërisë për vjetërsi shërbimi, llogaritet nga data e titullimit oficer, nënoficer dhe ushtar dhe i fillon efektet nga data e fillimit të marrëdhënieve financiare të parashikuara në urdhrin e rititullimit.

22. Kontrata me Forcat e Armatosura kur ushtaraku në rezervë rikthehet në shërbim aktiv.

- a) Kontrata për ushtarakët në rezervë që rikthehen në shërbim aktiv në Forcat e Armatosura nënshkruhet midis ushtarakut dhe Forcave të Armatosura sipas përcaktimit në nenin 31, të ligjit nr.59/2014, datë 12.06.2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, por, jo më shumë se 3 (tre) vjet, me të drejtë rinovimi, sipas formatit bashkëlidhur.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT.

- 23. Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi: Komandantët e Forcave, Komandanti i Komandës Mbështetëse, Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, komandantët e reparteve të varësisë të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Qendra e Personel Rekrutimit, Policia Ushtarake, AISM, Njësia Mjekësore Ushtarake, Drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
- 24. Ndjekin zbatimin e këtij udhëzimi Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë së Mbrojtjes.
- 25. Bashkëlidhur;
 - Formulari nr.1, "Formulari i vlerësimit të dokumenteve të kandidatëve oficer nga çdo anëtar i komisionit".

- Formulari nr.1/1, "Formulari i vlerësimit të dokumenteve të kandidatëve nënoficer dhe ushtar/detar aktiv nga çdo anëtar i komisionit".
- Formulari nr.1/2, "Formulari i vlerësimit të dokumenteve të kandidatëve oficer nga komisioni".
- Formulari nr.1/3, "Formulari i vlerësimit të dokumenteve të kandidatëve nënoficer dhe ushtar/detar aktiv nga komisioni".
- Formulari nr.2, "Formulari i vlerësimit të intervistës me gojë për oficer nga çdo anëtar komisioni".
- Formulari nr.2/1, "Formulari i vlerësimit të intervistës me gojë për oficer nga komisioni".
- Formulari i aplikimit për rikthim në shërbimin aktiv në Forcat e Armatosura.
- Formulari vetëdeklarimi.
- Formulari vetëdeklarimi për zbatimin e ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike".
- Aneksi C, "Formulari vetëdeklarimi për gjendjen shëndetësore të kandidatit për rikthim në Forcat e Armatosura".
- Formulari i pranimit të dokumentacionit të aplikantit për rikthim në shërbim aktiv në Forcat e Armatosura.
- Aneksi D, Vlerësimi i kandidatëve për intervistën.
- Kontratë për shërbimin ushtarak aktiv për ushtarakët e rikthyer në Forcat e Armatosura.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Pirro Vengu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA
QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT

Formulari nr.1

Formulari i vlerësimit të dokumenteve të kandidatëve oficer
nga çdo anëtar i komisionit

Emri, Mbiemri i kandidatit: _____

Reparti/Struktura: _____

Pozicioni i punës: _____

KRITERET E VLERËSIMIT		VLERËSIMI
1. Vlerësimi i jetëshkrimit (CV)	(10)	
2. Vlerësimi i arsimit/kualifikimit	(15)	
a. Arsimimi civil		
Për pozicionet e punës me arsim të mesëm: Diploma e arsimit të mesëm/parauniversitar, vlerësimi bëhet sipas notës mesatare.		
b. Për pozicionet e punës me arsim të lartë: Diplomat e arsimit të lartë vlerësohen sipas nivelit të tyre, vlerësimi bëhet sipas notës mesatare		
Diploma Bachelor		
Diploma Master Profesional		
Diploma Master Shkencor		
Diploma ushtarake		
3. Vlerësimi i trajnimit	(10)	
Plotësimin e kërkesave lidhur me pozicionin;		
Tejkalim të kërkesave (1-3 trajnime shtesë, të lidhura me pozicionin);		
Tejkalim domethënës të kërkesave (më shumë se 3 trajnime shtesë të lidhura me pozicionin).		
4. Vlerësimi i eksperiencës në punë	(25)	
Për plotësimin e kërkesave;		
Për tejkalim të lehtë të kërkesave (deri në 1 vit përvojë shtesë në fushën e kërkuar ose për përvojë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar);		
Për tejkalimin e kërkesave (nga 1-3 vite shtesë në fushën e kërkuar ose për përvojë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar);		
Për tejkalim domethënës të kërkesave (më shumë se 3 vjet në fushën e kërkuar ose për përvojë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin).		
SHUMA E PIKËVE	(60)	

2. Anëtar _____

Data _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA
QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT

Formulari nr.1/1

Formulari i vlerësimit të dokumenteve të kandidatëve nënoficer dhe ushtar/detar
nga çdo anëtar i komisionit

Emri, Mbiemri i kandidatit: _____
Reparti/Struktura: _____
Pozicioni i punës: _____

KRITERET E VLERËSIMIT		VLERËSIMI
1. Vlerësimi i jetëshkrimit (CV)	(20)	
2. Vlerësimi i arsimimit/kualifikimit	(35)	
c. <i>Arsimimi civil</i> Për pozicionet e punës me arsim të mesëm: Diploma e arsimit të mesëm/parauniversitar, vlerësimi bëhet sipas notës mesatare. Deshmi/certifikata ushtarake		
d. Për pozicionet e punës me arsim të lartë: Diplomat e arsimit të lartë vlerësohen sipas nivelit të tyre, vlerësimi bëhet sipas notës mesatare Diploma Bachelor Diploma Master Profesional Diploma Master Shkencor		
3. Vlerësimi i trajnimit	(25)	
Plotësimin e kërkesave lidhur me pozicionin;		
Tejkalim të kërkesave (1-3 trajnime shtesë, të lidhura me pozicionin);		
Tejkalim domethënës të kërkesave (më shumë se 3 trajnime shtesë të lidhura me pozicionin).		
4. Vlerësimi i eksperiencës në punë	(25)	
Për plotësimin e kërkesave;		
Për tejkalim të lehtë të kërkesave (deri në 1 vit përvojë shtesë në fushën e kërkuar ose për përvojë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar);		
Për tejkalimin e kërkesave (nga 1-3 vite shtesë në fushën e kërkuar ose për përvojë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar);		
Për tejkalim domethënës të kërkesave (më shumë se 3 vjet në fushën e kërkuar ose për përvojë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin).		
SHUMA E PIKËVE	(100)	

2. Anëtar _____

Data _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA
QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT

Formulari nr. 1/2

Formulari i vlerësimit të dokumenteve të kandidatëve oficer nga Komisioni

Emri, Mbiemri i kandidatit: _____

Reparti/Struktura: _____

Pozicioni i punës: _____

Kriteret e vlerësimit	Vlerësuesi i parë	Vlerësuesi i dytë	Vlerësuesi i tretë	Shuma e pikëve
1. Vlerësimi i jetëshkrimit				
Vlerësimi i CV-së. Vlerësohet njëloj për të gjithë kandidatët				5
2. Vlerësimi i Arsimit/Kualifikimit				
e. Për pozicionet e punës me arsim të mesëm Diploma e arsimit të mesëm/parauniversitar, vlerësohet deri në 15 pikë. Vlerësimi bëhet sipas notës mesatare.				
f. Për pozicionet e punës me arsim të lartë. Diplomat e arsimit të lartë vlerësohen sipas nivelit të tyre. Vlerësimi bëhet sipas notës mesatare				
Diploma Bachelor vlerësohet deri 5 pikë				
Diploma Master Profesional vlerësohet deri 10 pikë				
Diploma Master Shkencor vlerësohet deri 15 pikë				
3. Vlerësimi i trajnimeve				
1 pikë për plotësimin e kërkesave lidhur me pozicionin.				

3 pikë për tejkalim të kërkesave (1-3 trajnime shtesë, të lidhura me pozicionin).				
5 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave (më shumë se 3 trajnime shtesë të lidhura me pozicionin).				
4. Vlerësimi i përvojës në punë/eksperiencës				
2 pikë për plotësimin e kërkesave.				
5 pikë për tejkalim të lehtë të kërkesave - deri në 1 vit përvojë shtesë në fushën e kërkuar ose për përvojë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar;				
